



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:223459  
Datë: 17.10.2024  
Numri i dokumentit: 06313627

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0176-A0001

*Paditësi/Ankuesi*

N.Z “Th”, Pejë, me përfaqësues avokatin F N, Gjilan

**Kundër:**

*E paditura*

N.SH “Trasing” (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-7077, të datës 6 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-7077, i datës 6 mars 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 19 nëntor 2014, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN036-0528 të datës 30 maj 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për obligim të pa përmbushur kontraktual në shumën prej 7,136.36 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se kërkesa do të duhej të ishte dorëzuar në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga koha kur N.SH pretendohet të mos ketë kryer ndaj parashtruesit obligimin që rrjedh nga marrëdhënia tregtare që është tre vite nga 31 maj 2004, kur parashtruesi nuk ka marrë pagesën e faturës së fundit të lëshuar për N.SH-në.

Në ankesën e ankuesit ishte theksuar se pretenduesi i kërkesës që nga momenti i krijimit të detyrimeve dhe arritjes së afateve për pagesë të detyrimit sipas faturave të shkëmbyera në këtë raport tregtar, disa herë ka kërkuar nga ndërmarrja shoqërore “Trasing” (në likuidim) pagesën e detyrimit kontraktual. Nga ana e ndërmarrjes në vazhdimësi është pranuar borxhi por është theksuar pamundësia financiare e përmbushjes së detyrimit kontraktues. Për të konstatuar pranimin e borxhit nga ana e ndërmarrjes gjykatës i kishte propozuar që ta ftoj në seancë dëgjimore ose marrjen e deklaratave verbale nga ana e ish menaxherit të N.SH-së për të konstatuar borxhin e ndërmarrjes ndaj biznesit individual N.Z. “Th Pejë”.

Andaj, gjykatës i kishte propozuar që të anuloj vendimin e AL-së dhe të miratoj në tërësi të bazuar ankesën e ankuesit ashtu që e paditura të përmbushë obligimin e saj kontraktual në shumë prej 7,136.36 euro me interes ligjor prej 10% si dhe të detyrohet e paditura që t’i kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës.

Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN036-0528 të datës 30 maj 2013, fletëkthesën e pranimit të vendimit, formularin për parashtrimin e kërkesës për likuidim të datës 9 gusht 2007, një kontratë për kryerjen e punëve me nr. 1025 të datës 5 nëntor 2002, një faturë me nr. 589, një fletëdërgesë e datës 12 mars 2004, një parashtrësë me Sqarime lidhur me borxhin që ka “Trasing” ndaj firmës “Th” në Pejë të datës 9 gusht 2007 si dhe patentë shoferin e paditësit.

Me datë 10 mars 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nën i ligjit për AKP-në është shkelur nga AL në

marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74 paragrafi 2 të Ligjit për DHPGJS-në i cili parasheh që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Në rastin konkret kërkesa e paditësit do të duhej të ishte dorëzuar në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga koha kur N.SH pretendohet të mos ketë kryer ndaj parashtruesit obligimet e saj pra nuk ka marrë pagesën e faturës së fundit të lëshuar për N.SH-në. Andaj e paditura në rastin konkret i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AL-së. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të AL-së.

Me datë 12 gusht 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtjen e AKP-së në të cilën i kishte përsëritur pretendimet e saj si në ankesë dhe i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, të shfuqizohet vendimi i ankimuar i AL-së dhe të obligohet AL që ankuesit në emër të kompensimi të detyrimit të pa përmbushur kontraktual t'ia paguaj shumën prej 7,136.36 euro me interes ligjor prej 10%, nga momenti i krijimit të detyrimit e deri në pagesën definitive dhe të obligohet AL që ankuesit t'ia paguaj shpenzimet procedurale.

Me datë 11 tetor 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin, përmes të cilit kishte kërkuar nga i njëjti që të sqaroj disa fakte vendimtare të rastit siç është fakti se a i ka përfunduar punime e kontraktuara, a ka pasur pranim teknik të punimeve, cilat fatura janë lëshuar, cilat janë paguar dhe cilat nuk janë paguar.

Me datë 2 nëntor 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e gjykatës duke theksuar se po të gjitha punimet janë përfunduar sipas marrëveshjes me përfaqësuesit e palës së paditur. Tutje lidhur me pyetjen se e ka pasur pranim teknik të punimeve kishte theksuar se për shkak të kohës së gjatë të ndodhjes së raportit material juridik-punimeve të kryera, palës paditëse nuk mund t'i kujtohet se a është bërë pranimi teknik në kuptimin e sotëm të fjalës.

Megjithatë duke marrë për bazë faktin se me rastin e adresimit të kërkesave për pagesë nga ana e palës paditëse, të njëjtit asnjëherë në asnjë formë nuk i është theksuar një çështje e tillë-pranim teknik i punimeve. Pala paditëse beson se është bërë pranimi teknik nga autoritetet kompetente-Drejtoria e Rrugëve.

Sa i përket pyetjes së gjykatës se cilat fatura janë lëshuar, cilat janë paguar dhe cilat nuk janë paguar, paditësi ishte përgjigjur se për shkak të distancës kohore nga koha e zhvillimit të punëve,

palës paditëse nuk mund ti kujtohet kjo rrethanë. Për më tepër gjithë dokumentacioni ishte dorëzuar tek pala e paditur. Pala paditëse thekson se do të bëj përpjekje për sigurimin e datës dokumentacionit të tillë, mirëpo aktualisht objekti/hapësirat e rrugëve janë në renovim dhe stafi është shpërngulur në ndërtesë tjetër të punës dhe për këtë arsye aktualisht nuk është duke punuar arkiva e këtij Institucioni.

Me datë 21 nëntor 2022, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë për plotësimin e përgjigjes në urdhër të cilit i kishte bashkëngjitur kontratën për kryerjen e punëve dhe disa fotografi nga vendi i ngjarjes.

Me datë 6 mars 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-7077 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që kishte vërtetuar vendimin e AL-së. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se siç është parë nga përmbajtja e faturave ato janë lëshuar me datë 31 maj 2004, ndërsa kërkesa kreditore është paraqitur me datë 9 gusht 2007. Në kohën e raportit afarist të pretenduar me kërkesëpadi ka qenë në fuqi ligji material i LMD-së i viti 1978 i cili në nenin 374 kishte përcaktuar se kërkesat reciproke nga kontrata për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve në mes të subjekteve juridike apo tregtare parashkruhen për tri vite.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë nga qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve të pretenduar nga një subjekt afarist ndaj subjektit tjetër afarist, prej nga rrjedh se kërkesa e paditësit është e parashkruar. Fatura e fundit është lëshuar me datë 31 maj 2004, që do të thotë se afati përfundimtar për pagesat e faturave ishte data 30 qershor 2004. Rrjedhimisht me datë 1 korrik 2007, kërkesa është parashkruar, ndërsa kërkesa kreditore është paraqitur pranë AL-së pas kalimit të afatit tre vjeçar, respektivisht me 9 gusht 2007.

Paditësi gjatë procedurës gjyqësore e kishte kundërshtuar pretendimin e të paditurës se kërkesa për kompensim borxhi është parashkruar, duke propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit ish menaxhmenti i ndërmarrjes, që në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme dhe nuk i shërben gjykimit të drejtë dhe të ligjshëm që ish menaxhmenti i ndërmarrjes të dëgjohet si dëshmitare, në ato rrethana të prezantuara.

Andaj gjykata kishte konsideruar se faktet rreth atyre kontratave, rreth detyrimeve që dalin prej tyre dhe rreth përmbushjes së tyre, duke përfshirë edhe çështjet nëse ka pasur pohim borxhi dhe ndërprerje parashkrimi, duhet të provohen me prova materiale, respektivisht me dokumente afariste, të cilat pala paditëse nuk i ka pasur në dispozicion gjatë gjykimit.

Me datë 27 mars 2023, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-7077 të datës 6 mars 2023 (aktgjykimi i ankimuar), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të aprovohet si plotësisht e bazuar ankesa e ankuesit, të shfuqizohet aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e kërkesës kreditore të paditësit në shumën prej 7,136.36 euro me interes ligjor prej 10%.

Në ankesë ankuesi kishte theksuar se refuzimi i propozimit për dëgjimin e dëshmitarit është i pakuptimtë dhe i paqartë dhe vlerësimi i një provë të pa administruar asnjëherë se e njëjta nuk i shërben gjykimit të drejtë he të ligjshëm mbetet poashtu e pakuptimtë për paditësin. Dëgjimi i dëshmitarit nuk do të duhej të refuzohej në mbështetje të një fjalie iluzive si “rrethana të prezantuara”. Gjykata në vazhdimësi kishte bërë konstatime të njëpasnjëshme që dërgojnë në një rezultat plotësisht të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Arsyetimi i gjykatës i mos marrjes në administrim të dëgjimit të ish menaxhmentit ishte se kontrata e ndërtimit ishte kontratë formale e cila duhet të lidhet në formë me shkrim andaj edhe deklarata e pohimit të borxhit supozohet se duhet të bëhet me shkrim. Gjykata me aktgjykimin e saj konstaton praktikën dhe standardet e saj afaristë të krijuara ndërmjet tregtarëve dhe paditësi thekson se sipas praktikës tregtare në dokumente standarde afaristë hyjnë format për mënyrat e furnizimit, dëgjimet e porosive për dorëzim te porositësi, pranimi dhe kontrollimi i dërgesave të dorëzuara, kontrollimi i kuantitetit të produkteve, kontrolli i cilësive etj, mirëpo asnjëherë faktet juridike të cilat kanë të bëjnë veçanërisht me pohimin e borxhit si fakt juridik për ndërprerjen e parashkrimit e të cilat fakte ndërlidhen vetëm me të drejtë.

Përfundimisht gjykata në asnjë rast nuk mund të bëjë interpretime të pabazuara në ligj dhe veçanërisht të konstatoj dhe vërtetoj praktikën e subjekteve afariste pa baza të mjaftueshme dhe të qarta. Gjithashtu sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, ankuesi thekson se gjykata bën një interpretim krejtësisht të gabuar të dispozitave të nenit 368 duke përcaktuar se pranimi i debitorit si mënyrë për ndërprerjen e parashkrimit duhet të bëhet decidivisht me shkrim.

Me datë 11 janar 2024, e paditura (AKP) kishte paraqitur përgjigje ndaj ankesës në të cilën thekson se përsëritja e argumenteve që janë parashtruar më parë do të ishte e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i propozon Kolegjit të Apelit të refuzoj apelin si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të neni 69.1 të Ligjit nr.06/L086 mbi dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ( LDHP) Kolegji vendos të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Në bazë të nenit 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve, kërkesat reciproke në mes personave juridik të cilat dalin nga kontratat e lidhura në mes tyre, parashkruhen në afatin prej 3 vite.

Në bazë të nenit 387 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.

Në këtë lëndë borxhi i pretenduar nga ankuesi bazohet në disa fatura të lëshuara. Fatura e fundit ishte e dates 31 maj 2004. Edhe Kolegji i Apelit ashtu siç ka konstatuar shkalla e parë, se me datë 1 korrik 2004 ka filluar të rrjedh afati i ri i parashkrimit dhe pas kalimit të afatit prej 3 viteve, saktësisht me datë 1 korrik 2007 kërkesa ishte parashkruar, ndërsa kërkesa kreditore para AL-së ishte parashtruar me datë 9 gusht 2007.

Ankuesi ishte drejtuar tek Autoriteti i Likuidimit edhe më vonë, përkatësisht me datë 9 gusht 2007 që parashkrimi i kërkesës është i padiskutueshëm. Në një rrethanë të tillë dëgjimi i dëshmiarit të propozuar nga paditësi do të ishte i pa dobishëm. Pas kësaj date ankuesi nuk kishte arritur të parashtronte asnjë provë me të cilën mund të dëshmonte nderprejen e parashkrimit. Andaj, mbajtja e një seance dëgjimore do të ishte plotësisht e panevojshme pasi që nuk do ta ndryshonte rezultatin.

Rrjedhimisht mund të konstatohet se kërkesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor, andaj ajo është parashkruar në kuptim të nenit 374 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në bazë të nenit 387 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, është e qartë se e paditura nuk ka dhënë ndonjë deklaratë me shkrim për pranimin e borxhit, apo ajo nuk ka marrë ndonjë veprim tjetër të tërthortë për njohje të borxhit, të përcaktuar me dispozitën e cekur ligjore, andaj në rastin e këtij ankuesi nuk ka ndërprerje të parashkrimit.

Në bazë të nenit 374 të LMD-së, ankuesi kishte në dispozicion 3 vite për ta kërkuar borxhin ndaj N.SH-së në DHPGJS, mirëpo ai ka dështuar të paraqes padi të afatshme në DHPGJS.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson të saktë Aktgjykimin e shkallës së pare të DHPGJS-së kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye edhe Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e ankuesit duhet refuzuar si e pabazuar ndërsa Aktgjykimi i ankimuar duhet të Vertetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Për arsyet e mësipërme e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendosë si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi me datë 27 prill 2023 kishte paguar taksën gjyqësore, andaj i njëjti nuk mund të ngarkohet me taksë shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së me datë 17 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_